

Prezantimi i Republikës së Kosovës para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë: aspekte procedurale

*Lendita Memeti-Kamberi**

Përmbledhje

Tashmë një vit nga shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës nga Serbia, më 17 shkurt 2008, institucionet e Kosovës kanë para vetes sfidën e madhe të promovimit të një njohje sa më të gjerë të saj nga shoqëria ndërkombëtare.¹

Në një të ardhme të afërme, pavarësia e Kosovës do t'i nënshtrohet edhe një vlerësimi juridik nga ana e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.² Në kuadër të kërkesës për një mendim konsultativ, drejtuar nga Asambleja e Përgjithshme në bazë të nenit 96 të Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara, me iniciativën e Serbisë, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë është thirrur t'i përgjigjet pyetjes nëse "shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes së Kosovës është në pajtim me të drejtën ndërkombëtare apo jo?"³

Fjalët kyç: pavarësia e Republikës së Kosovës, mendimi konsultativ, jurisprudenca e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, gjykatësit ad hoc pranë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

* Dr. sc. Lendita Memeti-Kamberi, e atashuar në Fakultetin Juridik të Universitetit Lille 2, Francë.

¹ Sipas të dhënave zyrtare të dhjetorit 2008, Republikën e Kosovës e kanë njohur 53 prej gjithsej 192 shteteve anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

² Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë është organ gjyqësor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

³ Rezoluta A/RES/63/3 e adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 8 tetor 2008, <http://daccessdds.un.org/doc/UNDOC/GEN/N08/470/98/PDF/N0847098.pdf?OpenElement>, parë për herë të fundit më 2 shkurt 2009.

Ky punim synon të shpjegojë kontekstin e ftesës që i është bërë Republikës së Kosovës për të mbrojtur kauzën e saj para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (I.). Pa dashur të paragjykohet vendimi final i GJND-së., ai ka për objektiv të analizojë rolin që luan pëlqimi i Kosovës për ushtrimin e kompetencës së Gjykatës (II) dhe mundësinë eventuale që Republika e Kosovës të caktojë një gjykatës *ad hoc* pranë GJND-së për këtë çështje (III).

I. Ftesa e bërë Republikës së Kosovës për t'u prezantuar para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë

Në bazë të nenit 96 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara mund të kërkojnë mendimin e Gjykatës mbi çdo çështje juridike të së drejtës ndërkombëtare. Organet e tjera dhe institucionet e specializuara të OKB-së kanë një të drejtë të tillë vetëm për sa u përket çështjeve juridike që shtrohen në kuadër të aktivitetit të tyre, dhe atë me autorizimin shprehimor të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

Vërejmë që, në dallim nga funksioni kontestimor,⁴ procedura konsultative e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ndaj shteteve nuk hapet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Një gjë e tillë shpjegohet me faktin që juridiksioni i Gjykatës Ndërkombëtare

⁴ Përpos kompetencës konsultative, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë është kompetente për të shqyrtuar mosmarrëveshjet juridike mes shteteve anëtare të OKB-së., dhe eventualisht shteteve të tjera që kanë pranuar Statutin e Gjykatës ose kanë pranuar juridiksionin e saj në kushte të caktuara të parapara për këtë qëllim. Gjykata nuk mund ta ushtrojë funksionin e saj kontestimor përveç në rastet kur shtetet në fjalë kanë pranuar juridiksionin e saj në njërin nga tri mënyrat në vijim: përmes një mosmarrëveshjeje të quajtur kompromis, të lidhur mes tyre me qëllim që t'ia nënshtrojnë mosmarrëveshjen e tyre për shqyrtim GJND-së; në bazë të një klauzole kompromisi të përfshirë në një traktat, përmes së cilës shtetet palë angazhohen t'ia nënshtrojnë GJND-në çdo mosmarrëveshjeje të ardhshme lidhur me interpretimin dhe zbatimin e këtij traktati; në bazë të deklaratës për pranimin e juridiksionit të GJND-së, të bërë në bazë të Statutit dhe në bazë të së cilës çdo shtet që ka bërë një deklaratë të tillë e pranon si të obligueshëm juridiksionin e Gjykatës për çdo mosmarrëveshje që mund të ndodhë në të ardhmen mes tij dhe një shteti tjetër që ka bërë një deklaratë të ngjashme.

të Drejtësisë është fakultativ dhe jo i obligueshëm, çka do të thotë se një çështje mund t'i nënshtrohet Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shqyrtim vetëm në rastet kur të dyja palët në kontest kanë pranuar shprehimisht juridiksionin e saj. Kështu, autorizimi i shteteve për të thirrur Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë për të dhënë një mendim konsultativ do të ishte në kundërshtim me këtë parim, sepse, duke kërkuar një mendim të tillë nga Gjykata, njëra nga palët në konflikt do ta sillte palën tjetër para një fakti të kryer edhe nëse kjo e fundit nuk ka njohur juridiksionin e Gjykatës.

Është evidente që në origjinën e një kërkesë për një mendim konsultativ është propozimi i një shteti apo një grupi shtetesh, anëtare të organit që shtron kërkesën për mendimin konsultativ, që për rrjedhojë ka një rezolutë të organit të interesuar, të miratuar sipas procedurës së paraparë për këtë qëllim. Në rastin e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, kërkesa për një mendim konsultativ nuk konsiderohet si një çështje e rëndësishme që kërkon votimin nga shumica e dy të tretave, e paraparë nga neni 18 i Kartës së OKB-së.⁵ Në rastin e Këshillit të Sigurimit, një kërkesë e tillë konsiderohet si një çështje substanciale që nënkupton se votimi i saj i nënshtrohet vetos së shteteve anëtare të përhershme – Britanisë së Madhe, Francës, Kinës, Rusisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.⁶

Kështu, rezoluta A/Res/63/ 3 që përmban kërkesën për mendimin konsultativ drejtuar Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi çështjen nëse shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës është në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, është miratuar më 8 tetor 2008, në bazë të Projektrezolutës A/63/L.2

⁵ Kështu, e thirrur në bazë të Rezolutës 49/75 K e datës 15 dhjetor 1994, që shtron çështjen e ligjshmërisë së kërcënimit apo përdorimit të forcës nukleare, GJND-ja nuk ka shtjelluar *ex officio* çështjen e vlefshmërisë së saj, edhe pse kjo rezolutë nuk ishte adoptuar nga shumica e dy të tretave të votave.

⁶ Në rastin e vetëm kur ai ka marrë iniciativën për t'i kërkuar GJND-së. një mendim konsultativ sa u përket pasojave juridike për shtetet, të pranisë të vazhdueshme të Afrikës së Jugut në Namibi, Rezoluta 284 (1970) ishte miratuar me 12 vota pro dhe abstenimin e Polonisë, Britanisë së Madhe dhe ish-Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike (sipas parimit të karriges së zbrazët, abstenimi nuk është ekuivalent i vendosjes së vetos dhe nuk e pengon miratimin e një vendimi për të cilin kërkohet njëzëshmëria e shteteve anëtare të përhershme).

që Serbia i ka paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, më 23 shtator 2008.

Edhe pse shtetet anëtare të OKB-së janë përjashtuar nga e drejta për të kërkuar një mendim konsultativ në mënyrë të drejtpërdrejtë, ato kanë mundësinë të paraqesin pikëpamjet e tyre pranë Gjykatës për sa u përket çështjeve juridike që janë objekt i kërkesës për mendimin konsultativ. Në këtë rast, cilësia e tyre si anëtare të OKB-së është një provë e interesit të tyre juridik për t'u prezantuar pranë Gjykatës dhe nuk kanë nevojë të justifikojnë ekzistimin e një interesi subjektiv që vihet në pyetje nga faktet që gjenden në origjinë të mosmarrëveshjes me një shtet tjetër.

Situata është më delikate kur mendimi konsultativ ka të bëjë me aktorë të tjerë të shoqërisë ndërkombëtare si p.sh. me organizatat e tjera ndërkombëtare apo ndonjë entitet me status juridik të kontestueshëm. Është e qartë që këto nuk kanë të drejtë automatike për t'i drejtuar Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë pikëpamjen e tyre mbi çështjen në fjalë. Në praktikë, në respekt të parimit të barazisë së palëve, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë është treguar mjaft e hapur, edhe pse sjellja e saj nuk ka qenë gjithmonë konstante në këtë drejtim. Kështu, më 1954, Federata e Shoqatave të Funkionarëve Ndërkombëtarë nuk është thirrur të ofrojë të dhëna për çështjen *Efektet e aktgjykimeve të Tribunalit Administrativ të Kombeve të Bashkuara*.⁷ Më 1962, për çështjen mbi *Statusin ndërkombëtar të Afrikës Jug-Perëndimore*, Gjykata kishte pranuar të marrë mendimin e Ligës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut sa u përket aspekteve juridike, por jo dhe atyre faktike.⁸ Më 1971, Sekretaria e Gjykatës ka refuzuar pjesëmarrjen e Organizatës së Unitetit Afrikan për çështjen e Namibisë⁹, ndërsa Gjykata i ka lejuar më pas Namibisë të mbrojë pikëpamjet e saj.¹⁰ Në vitin 2004, Palestinës i është

⁷ SAVOIE (P.-O.), «La C.I.J., l'avis consultatif et la fonction judiciaire: entre décision et consultation», <http://cfci-fcjc.org/clearinghouse/drpapers/2005-dra/savoie.pdf>, f. 41, parë për herë të fundit më 2 shkurt 2009.

⁸ *Ibidem*.

⁹ GJND., Mendimi konsultativ i datës 21 qershor 1971, *Pasojat juridike për shtetet e pranisë së vazhdueshme të Afrikës së Jugut në Namibi*, Përmbledhja 16, f. 41.

¹⁰ *Ibidem*.

njohur zyrtarisht e drejta për të shprehur pikëpamjet e saj në çdo procedurë konsultative në lidhje me *Pasojat juridike të ndërtimit të një muri në territorin e okupuar të Palestinës*.¹¹ Në të njëjtën procedurë, Organizata e Konferencës Islamike dhe Liga e shteteve arabe kanë fituar të drejtën të marrin pjesë me kërkesën e tyre. Shembulli i çështjes së *Pasojat juridike të ndërtimit të një muri në territorin e okupuar të Palestinës* ka qenë deri më tani rasti i parë dhe i vetëm, në të cilin një entitet që nuk është në një organizatë ndërkombëtare është thirrur të japë të dhëna në një procedurë konsultative pranë GJND-së. Rëndësia e këtij precedenti është aq më e madhe kur njihet situata e veçantë e saj jo si një shtet ekzistues por si një shtet për t'u krijuar në të ardhmen.

Përkujtimi kronologjik i të gjithë shembujve, në të cilët entitete të tjera, pos shteteve anëtare dhe organeve të OKB-së, janë thirrur të paraqesin opinionin e tyre në një procedurë konsultative pranë GJND-së, ka për qëllim të shpjegojë rëndësinë e ftesës që GJND i ka bërë institucioneve të Republikës së Kosovës për të paraqitur pikëpamjet e tyre në lidhje me pajtueshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës me të drejtën ndërkombëtare. Edhe pse juridikisht asgjë nuk e ka obliguar GJND-në për një gjë të tillë, me urdhëresën e saj të datës 17 tetor 2008¹², Republika e Kosovës është ftuar të marrë pjesë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë me OKB-në dhe shtetet e saj anëtare në procedurën konsultative që ka të bëjë statusin juridik të saj. Kështu, deri më 17 prill 2009, OKB-ja dhe shtetet anëtare të interesuara, si dhe aktorët e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kanë të drejtë t'i parashtrajnë pikëpamjet e tyre me shkrim, pranë GJND-së., konform me nenin 66 § 2 të Statutit të saj. Më pas, në pajtim me nenin 66 § 4 të Statutit të GJND-së., të gjitha këto mund t'i drejtojnë

¹¹ GJND., Mendimi konsultativ i datës 9 korrik 2004, *Pasojat juridike të ndërtimit të një muri në territorin e okupuar të Palestinës*, Përmbledhja 2004, f. 136.

¹² GJND., Urdhëresa e 21 tetorit 2008 mbi caktimin e afateve për ekspozetë e shkruara dhe vërejtjet gojore në çështjen Pajtueshmëria me të drejtën ndërkombëtare të shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës nga institucionet e përkohshme të administrimit autonom të Kosovës <http://www.icj-cij.org/docket/index.php?p1=3&p2=4&k=21&case=141&code=kos&p3=3>, parë për herë të fundit më 23 shkurt 2009.

Gjykatës, deri më 17 korrik 2009, vërejtje me shkrim si përgjigje në ekspozetë me shkrim të palëve të tjera.

II. Pëlqimi i Republikës së Kosovës i nevojshëm për ushtrimin e kompetencës konsultative të GJND-së.?

Nisur nga parimi i juridiksionit fakultativ të GJND-së., mund të shtrohet pyetja: cili do ishte efekti i kundërshtimit të Republikës së Kosovës që GJND-ja të shqyrtojë çështjen e pavarësisë së saj për arsye se Kosova nuk është anëtare e OKB-së dhe nuk ka pranuar juridiksionin e GJND-së.

Përgjigja e kësaj pyetjeje është e kushtëzuar nga përgjigja e një pyetjeje tjetër të shtruar në një kuptim më të gjerë: nëse është e mundur që një shtet, i cili nuk dëshiron që GJND-ja të shqyrtojë një mosmarrëveshje në të cilën ai është palë apo edhe një çështje teorike të përgjithshme që prek interesat e tij, mund të kundërshtojë sepse nuk ka pranuar juridiksionin e Gjykatës dhe, për këtë arsye, GJND-ja të refuzojë kërkesën për një mendim konsultativ?

Më 1923, Gjykata e Përhershme e Drejtësisë Ndërkombëtare,¹³ paraardhëse e GJND-së, ka refuzuar të japë një mendim konsultativ në lidhje me interpretimin e traktateve të paqes ndërmjet Finlandës dhe ish-BRSS për sa i përket Karelisë Lindore, me motivin se ish-BRSS kishte refuzuar të marrë pjesë në procedurë, e kishte refuzuar këtë që në fillim dhe nuk e kishte njohur juridiksionin e GJPDN-së. Duhet përkujtuar gjithashtu se ish-BRSS nuk ishte anëtare e Shoqërisë së Kombeve, organ gjyqësor i të cilës ishte GJPDN.¹⁴

Përkundrazi, jurisprudenca e GJND-së nuk është shumë e qartë në këtë drejtim. Në mendimin e saj konsultativ të datës 30 mars 1950, në çështjen *Interpretimi i traktateve të paqes të lidhura mes Bullgarisë, Hungarisë dhe Rumanisë*, ajo shprehet se: *Pëlqimi i*

¹³ Gjykata e Përhershme e Drejtësisë Ndërkombëtare (GJPDN) ka qenë organi gjyqësor i Shoqërisë së Kombeve (organizatë paraardhëse e Organizatës së Kombeve të Bashkuara) dhe ka vepruar nga viti 1922 deri në vitin 1946.

¹⁴ SAVOIE (P.-O.), «La C.I.J., l'avis consultatif et la fonction judiciaire: entre décision et consultation», *op. cit.*, f. 43.

shteteve palë në një mosmarrëveshje është bazë e juridiksionit të Gjykatës për sa i përket procedurës kontestimore. Puna qëndron ndryshe kur bëhet fjalë për procedurën konsultative atëherë kur mendimi konsultativ ka të bëjë me një çështje juridike që qëndron pezull mes palëve. Përgjigja e Gjykatës ka vetëm një karakter konsultativ; si e tillë, ajo nuk ka efekt të detyrueshëm. Nga kjo rezulton se asnjë shtet, anëtar apo jo i Kombeve të Bashkuara, nuk ka cilësi të pengojë që të pranohet një mendim konsultativ, të cilin Kombet e Bashkuara e kanë konsideruar të nevojshëm, për të sqaruar veprimin e tyre.¹⁵

Megjithatë, në Mendimin Konsultativ të 16 tetorit 1975 në çështjen *Sahara Perëndimore*, ajo bie në një lloj kundërshtimi me këtë jurisprudencë të mëhershme kur pranon të krahasojë situatën e Spanjës si anëtare e OKB-së dhe atë të ish-BRSS si jo anëtare e Shoqërisë së Kombeve, në çështjen e cituar më lart të *Karelisë Lindore*. Sipas GJND-së, fakti që Shoqëria e Kombeve nuk kishte kompetencë për të shqyrtuar një mosmarrëveshje që ka të bëjë me shtete jo anëtare që refuzojnë intervenimin e saj, ka qenë arsye vendimtare që Gjykata e Përhershme e Drejtësisë Ndërkombëtare kishte abstenuar të përgjigjej.¹⁶ Ajo shton se në çështjen *Sahara Perëndimore*, Spanja [ishte] anëtare e Kombeve të Bashkuara dhe ka pranuar dispozitat e Kartës dhe të Statutit; me këtë ajo ka dhënë në një mënyrë të përgjithshme pëlqimin e saj që Gjykata të ushtrojë juridiksionin e saj konsultativ[...] dhe nuk mund të kundërshtojë në mënyrë të vlefshme që Asambleja e Përgjithshme të ushtrojë të drejtën e saj për t'u kujdesur për dekolonizimin e një territori jo autonom dhe të kërkojë një mendim konsultativ mbi çështjet që kanë të bëjnë me ushtrimin e kësaj të drejte.¹⁷ Siç është shprehur në këtë paragraf, arsyetimi i GJND-së lë të kuptohet se sikur Spanja të mos ishte anëtare e OKB-së ndoshta refuzimi i saj mund të motivonte refuzimin nga Gjykata të kërkesës për mendimin konsultativ në çështjen *Sahara Perëndimore*.

Një gjë është e sigurt: edhe përkundër mendimit të disa shteteve, GJND-ja është kategorike se pëlqimi i shtetit, që është

¹⁵ GJND., Mendimi konsultativ i datës 31 mars 1950, *Interpretimi i traktateve të paqes të lidhura në mes të Bullgarisë, Hungarisë dhe Rumanisë*, Përmbledhja 1950, fq. 71.

¹⁶ GJND., Mendimi konsultativ i datës 16 tetor 1975, *Sahara Perëndimore*, Përmbledhja 1975, fq. 16.

¹⁷ *Ibidem*.

subjekt i mendimit konsultativ, nuk është kusht për kompetencën e saj. Ajo konsideron se *pëlqimi i shtetit të interesuar ruan rëndësinë e vet jo për sa i përket kompetencës së Gjykatës, por për sa i përket vlerësimit nëse është e nevojshme që ajo të japë mendimin konsultativ.*¹⁸ Kështu, mungesa e pëlqimit të Shtetit të interesuar mund, në disa rrethana të bëjë që prononcimi i një mendimi konsultativ të jetë i papajtueshëm me karakterin gjyqësor të Gjykatës. I tillë do ishte rasti, nëse faktet dëshmojnë se pranimi i Gjykatës për t'u përgjigjur do kishte për efekt të shtrembërojë parimin sipas të cilit një shtet nuk është i detyruar t'ia nënshtrojë një mosmarrëveshje një zgjidhjeje gjyqësore pa pëlqimin e tij.¹⁹ Vetëm në raste të tilla, GJND mund të përdorë pushtetin diskrecionar që ajo gëzon në bazë të nenit 65 § 1 të Statutit të saj dhe të refuzojë të përgjigjet në kërkesën për mendim konsultativ. Duhet përkujtuar se GJND nuk ka refuzuar ndonjëherë një kërkesë për mendim konsultativ mbi këtë bazë.²⁰

Në këtë kontekst, rasti i Kosovës është shumë specifik. Teorikisht, nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare, një shtet ekziston që nga momenti që ekzistojnë në mënyrë kumulative tre elementet e tij: territori, popullata dhe një qeveri efektive. Republika e Kosovës disponon me të gjitha këto elemente dhe mund të konsiderohet si shtet nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare. Si e tillë, ajo mund të kundërshtojë se nuk është e lidhur me kompetencën e GJND-së për faktin se nuk është anëtare e OKB-së. dhe nuk është e lidhur me Kartën e as Statutin e GJND-së, e as që ka pranuar në ndonjë mënyrë tjetër juridiksionin e GJND-së. Në këtë regjistër, rasti i Kosovës është i ngjashëm me atë të ish- BRSS-së në rastin e cituar më lart të *Karelisë Lindore* dhe mund të pretendohet thirrja në jurisprudencën e Gjykatës së Përhershme të Drejtësisë Ndërkombëtare. Megjithatë nuk duhet harruar që qëndrimi i

¹⁸ Idem., f. 25.

¹⁹ Idem., f. 17.

²⁰ Vendimi për të refuzuar kërkesën për mendim konsultativ të drejtuar nga Organizata Ndërkombëtare e Shëndetit sa i përket *Ligjshmërisë së përdorimit të armëve nukleare në një konflikt të armatosur është bazuar në mungesë të kompetencës e jo në arsye që i përkasin pushtetit diskrecionar të Gjykatës (shih GJND. Mendimi konsultativ i datës 8 korrik 1996, Ligjshmëria e kërcënimit apo përdorimit të armëve nukleare, Përmbledhja 1996, f. 226.*

GJND-së në lidhje me këtë jurisprudencë të GJPDN-së. ka qenë në një mënyrë kontradiktor dhe nuk është e sigurt nëse GJND është e gatshme të ndjekë jurisprudencën e paraardhëses së saj. Aq më pak, kur dihet se vetë objekti i mendimit konsultativ që ka kërkuar Asambleja e Përgjithshme, në këtë rast, ka të bëjë me legalitetin e pavarësisë së Kosovës nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare, e me këtë vihet në pyetje edhe cilësia e Kosovës si shtet, që ka një personalitet juridik ndërkombëtar të barabartë me shtetet e tjera. Është vështirë e imagjinueshme që GJND të refuzojë këtë kërkesë për mendimin konsultativ, duke njohur situatën e veçantë të Kosovës si një territor që ka qenë me vite nën protektoratin e OKB-së dhe vazhdon të mbetet nën mbikëqyrjen e saj *sine die*. Për më tepër, e kaluara e dhimbshme e Kosovës bën që çështja e ligjshmërisë së pavarësisë së Kosovës të interpretohet në kuptim të gjerë si një çështje e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, domen ky në të cilën Karta e OKB-së i njih Asamblesë së Përgjithshme kompetenca të rëndësishme. Në këtë kontekst, jurisprudenca e GJND-së në aktgjykimet e sipërcituara në rastet *Interpretimi i traktateve të paqes të lidhura mes Bullgarisë, Hungarisë dhe Rumanisë*²¹ dhe *Sahara Perëndimore*,²² gjen një aplikim të pakontestueshëm, në kuptimin se GJND është treguar kategorike në mënyrë që asnjë shtet anëtar apo jo anëtar i OKB-së të mos mundet të pretendojë të pengojë në mënyrë të vlefshme që Kombet e Bashkuara në përgjithësi, e Asambleja e Përgjithshme në veçanti, të ushtrojnë funksionin e tyre. Sidoqoftë, Gjykata është zot i vendimeve të saj dhe asnjë hipotezë nuk mund të mbrohet apo përjashtohet me një saktësi absolute. Aq më tepër kur dihet se GJND. mund të përdorë në çdo moment pushtetin e saj diskrecionar dhe të refuzojë një kërkesë për mendim konsultativ me arsyetimin se nuk e konsideron këtë të dobishëm.

²¹ Shih sipër shën. 13.

²² Shih sipër shën. 14.

III. E drejta e Republikës së Kosovës për të caktuar një gjykatës *ad hoc* pranë GjND-së

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë përbëhet nga pesëmbëdhjetë gjykatës, të zgjedhur për një mandat nëntë vjeçar nga Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli i Sigurimit, nëse kanë fituar shumicën absolute të njërit dhe tjetrit organ të OKB-së. Përbërja e Gjykatës përtërihet çdo tre vjet për një të tretën e anëtarëve të saj. Ata duhet të jenë zgjedhur në mesin e personaliteteve që kanë reputacionin e një morali të lartë dhe që plotësojnë kushtet për të ushtruar funksionet gjyqësore ose që janë juristë të njohur në të drejtën ndërkombëtare. Përbërja e gjykatës duhet të përfaqësojë format e mëdha të civilizimit dhe sistemet juridike kryesore të botës. Dy shtetas të një shteti nuk mund të jenë në të njëjtën kohë gjykatës të përhershëm të GjND-së.

Në bazë të nenit 31 të Statutit të Gjykatës, shtetet të cilat janë palë në një çështje të prezantuar pranë Gjykatës e që nuk kanë ndonjë shtetas të tyre si gjykatës me mandat, kanë të drejtë të caktojnë një gjykatës *ad hoc* si anëtar të kolegjit të gjykatësve që do marrë vendimin mbi çështjen në fjalë. Kështu, konform alineas 2 të nenit 31 të Statutit, nëse njëra palë në një kontest pranë Gjykatës ka një shtetas të vetin si gjykatës me mandat, çdo palë tjetër ka të drejtë të caktojë një person, sipas zgjedhjes së vet, të marrë pjesë si gjykatës në atë çështje. Njësoj, edhe në situatën kur asnjëra nga palët në kontest nuk ka shtetas të vetin si gjykatës të GjND-së. Duhet theksuar që nuk është e obligueshme që ky person të ketë shtetësinë e shtetit në fjalë dhe në të shumtën e rasteve gjykatësit *ad hoc* nuk janë shtetas të shteteve që i kanë caktuar ata. Për aq kohë sa ushtron funksionin e tij, gjykatësi *ad hoc* gëzon të njëjtin status si gjykatësit e tjerë dhe merr pjesë në mënyrë të barabartë në marrjen e të gjitha vendimeve në lidhje me çështjen në fjalë.

Alinea 1 e neni 35 të Rregullores së Gjykatës kërkon që palët të cilat dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën për të caktuar një gjykatës *ad hoc* duhet ta bëjnë një gjë të tillë sa më parë që të jetë e mundur. Pala duhet të njoftojë Gjykatën për emrin, shtetësinë dhe biografinë e shkurtër të personit të zgjedhur si gjykatës *ad hoc* më së largu dy muaj para skadimit të afatit për prezantimin e kundërpërgjigjeve të shkruara. Nëse njëra palë vendos të abstenojë nga kjo e drejtë me kusht që këtë ta bëjë edhe pala

tjetër atëherë ajo e njofton Gjykatën dhe palën tjetër për këtë gjë. Nëse pala e kundërt vendos të caktojë një gjykatës *ad hoc*, atëherë Gjykata i jep një afat shtesë për të caktuar një gjykatës *ad hoc*, palës e cila fillimisht kishte hequr dorë nga kjo e drejtë. Njoftimi për caktimin e një gjykatësi *ad hoc* i komunikohet palës tjetër e cila mund të bëjë vërejtje në lidhje me këtë, brenda afatit të caktuar nga presidenti i Gjykatës. Nëse pas skadimit të këtij afati pala tjetër nuk ka bërë asnjë kundërshtim dhe Gjykata vetë nuk sheh asnjë pengesë për këtë, gjykatësi konsiderohet i caktuar dhe të gjitha palët informohen për këtë. Në rast kontesti apo dyshimi, Gjykata ruan të drejtën të marrë vendimin përfundimtar në lidhje me caktimin e një gjykatësi *ad hoc*.²³

Këto dispozita janë të destinuara në radhë të parë për t'u zbatuar në procedurën kontestimore, por, në pajtim me nenin 68²⁴ të Statutit të GJND-së, shteteve u është njohur e drejta për të caktuar gjykatës *ad hoc* edhe në procedurën konsultative.

Përbërja aktuale e GJND-së²⁵ nuk përmban shtetas të Serbisë. Megjithatë, është shumë e mundshme që Serbia të kërkojë caktimin e një gjykatësi *ad hoc* në bazë të nenit 31 alinea 2 të Statutit të GJND-së.²⁶

²³ Për ilustrim mund të përkujtojmë se në rastin e sipërcituar *Sahara perëndimore*, GJND i kishte refuzuar Mauritanisë caktimin e një gjykatësi *ad hoc* me motivin se nuk ishin plotësuar kushtet për një gjë të tillë meqë mendimi konsultativ që i ishte kërkuar nuk kishte të bënte me ndonjë kontest ekzistues mes Mauritanisë dhe Spanjës. Përkundrazi, kërkesa e Marokut për të caktuar një gjykatës *ad hoc* është pranuar nga Gjykata meqë mendimi konsultativ kishte të bënte pa kontestim me një mosmarrëveshje mes Spanjës dhe Marokut. (shih. GJND Mendimi konsultativ i datës 16 tetor 1975, *Sahara Perëndimore*, *vep. cit.*, f. 8).

²⁴ Neni 68 i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lexohet si në vijim: *Në ushtrimin e kompetencave të saj konsultative, Gjykata do të inspirohet gjithashtu nga dispozitat e këtij Statuti që zbatohen në çështjet kontestimore, në masën që ajo vetë i njeh këto të zbatueshme.*

²⁵ Përbërja e GJND-së gjatë vitit 2009 prezantohet si në vijim: Hisashi Owada (Japoni) - kryetar; Peter Tomka (Sllovakia) - nënkryetar; anëtarë: Shi Yiyong (Kinë); Abdul G. Koroma (Sierra Leone); Awn Shawkat Al-Khasawneh (Jordani); Thomas Buergenthal (Shtete të Bashkuara të Amerikës); Bruno Simma (Gjermani); Ronny Abraham (Francë); Kenneth Keith (Zelandë e Re); Bernardo Sepúlveda-Amor (Meksikë); Mohamed Bennouna (Marok); Leonid Skotnikov (Rusi); Antônio A. Cançado Trindade (Brazil); Abdulqawi Ahmed Yusuf (Somali); Christopher Greenwood (Mbretëria e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut).

²⁶ Për informim, Serbia ka caktuar Z. Milenko Kreca si gjykatës *ad hoc* në çështjen *Zbatimi i konventës për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit*, Kroacia kundër Serbisë, në procedurë e sipër pranë GJND-së.

Hartimi i dispozitës së nenit 31 alinea 1 dhe 2 le të kuptohet se e drejta për të caktuar një gjykatës *ad hoc* i është njohur çdo shteti që është palë në një mosmarrëveshje që është objekt i procedurës kontestimore apo konsultative pranë GJND-së pa marrë parasysh cilësinë e tyre si anëtare të OKB-së. Sigurisht, kjo dispozitë u destinohet në rend të parë shteteve anëtare, të cilat kanë pranuar jurisprudencën e Gjykatës. Megjithatë, është logjike që në rastet e rralla kur një shtet nga të rrallët që nuk janë anëtarë të OKB-së, gjendet në një mënyrë palë në një procedurë pranë OKB-së të ketë të drejta të barabarta si pala tjetër. Prandaj, në parim, edhe Republika e Kosovës, interesat e së cilës mund të preken nga mendimi konsultativ që Gjykata do japë në çështjen e pajtueshmërisë së pavarësisë së Kosovës me të drejtën ndërkombëtare, ka të drejtë të kërkojë caktimin e një gjykatësi *ad hoc* pranë GJND-së, në bazë të nenit 31 alinea 2 të Statutit të Gjykatës.

Përfundim

Vlen të përkujtohet që për dallim nga aktgjykimet e nxjerra në kuadër të procedurës kontestimore, mendimet konsultative të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë nuk kanë një forcë juridike të obligueshme për palët të cilave u drejtohen ato. Mendimi konsultativ nuk është një akt gjyqësor në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, por vetëm një shprehje e pikëpamjes së Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi çështjen që i është nënshtruar për konsultim.²⁷ Sidoqoftë, mendimet konsultative kanë një rëndësi të pakontestueshme sa i përket konstatimit të së drejtës ndërkombëtare pozitive dhe zënë të njëjtin vend në kuadër të jurisprudencës së Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, si dhe aktgjykimet e nxjerra në ushtrim të kompetencës së saj kontestimore. Në praktikë, mendimet konsultative kanë një autoritet moral ndaj shteteve, të cilat në të shumtën e rasteve pranojnë të sillen në pajtim me të.

²⁷ QUOC DINH (N.), DAILLIER (P.), PELLET (A.), *Droit International Public*, 6 ed., L.G.D.J., Paris, 1999, f. 870.

Në rastin e Kosovës, mendimi konsultativ i GJND-së. mund të ketë një ndikim të madh për rrjedhën e njohjes ndërkombëtare të shtetit të Republikës së Kosovës. Sigurisht, është vështirë e imagjinueshme që shtetet të cilat tashmë e kanë njohur Republikën e Kosovës të tërheqin prapa njohjen që kanë bërë në respekt të një mendimi konsultativ eventual që konsideron se shpallja e pavarësisë së Kosovës është bërë në shkelje të së drejtës ndërkombëtare. Të paktën, Gjykata nuk disponon me asnjë mjet juridik për t'i detyruar shtetet për një gjë të tillë. Efekti i një mendimi të tillë do të jetë më i shprehur sa i përket qëndrimit të shteteve hezituese apo atyre që kundërshtojnë kategorikisht pavarësinë e Kosovës, duke u ofruar një argument juridik për të mos njohur shtetin e ri të Kosovës.

Në një hipotezë tjetër të ndërtuar mbi supozimin se në duelin juridik mes parimit të sovranitetit dhe parimit të së drejtës së popujve për vetëvendosje, GJND do të bëjë të triumfojë këtë të dytin; kauza e Kosovës do fitojë një legjitimitet të pakontestueshëm. Kjo nuk do të mjaftojë për të "shëruar" nga fobia e precedentit, shtetet të cilat kanë brenda vetes territore me aspirata ndarjeje, por në përgjithësi do të jetë i favorshëm për njohjen ndërkombëtare të shtetësisë së Republikës së Kosovës. Prandaj, Kosova duhet të përdorë të gjitha mjetet procedurale dhe substanciale në dispozicion, për të bindur GJND-në në këtë drejtim.

Bibliografia

Vepra dhe artikuj:

COT (J.-P.), PELLET (A.), FORTEAU (M.), «Article 96» in *La Charte des Nations Unies: Commentaire article par article - II*, 3 ed. Economica, 2005, f. 2003-2021.

DUPUIS (P.M.), *Droit International Public*, 4 ed, Paris, Dalloz, 1998, 267 f.

GOMEZ-ROBLEDO (J.-M.), «L'Avis de la C.I.J. sur les conséquences juridiques de l'édification d'un mur dans le territoire palestinien occupé: timidité ou prudence?», *Revue Générale de Droit International Public*, 2005-2, f. 521-537.

SAVOIE (P.-O.), «La C.I.J., l'avis consultatif et la fonction judiciaire: entre décision et consultation»,

<http://cfcj-fcjc.org/clearinghouse/drpapers/2005-dra/savoie.pdf>.

QUOC DINH (N.), DAILLIER (P.), PELLET (A.), *Droit International Public*, 7 ed., Paris, L.G.D.J., 2002, 1510 f.

Jurisprudenca e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë:

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, Mendimi konsultativ i datës 9 korrik 2004, *Pasojat juridike të ndërtimit të një muri në territorin e okupuar të Palestinës*, Përmbledhja 2004, fq. 136.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, Mendimi konsultativ i datës 8 korrik 1996, *Ligjshmëria e kërcënimit apo përdorimit të armëve nukleare*, Përmbledhja 1996, f. 226.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, Mendimi konsultativ i datës 16 tetor 1975, *Sahara Perëndimore*, Përmbledhja 1975, f. 16.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, Mendimi konsultativ i datës 21 qershor 1971, *Pasojat juridike për shtetet, të pranisë të vazhdueshme të Afrikës së Jugut në Namibi*, Përmbledhja 16, f. 41.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, Mendimi konsultativ i datës 31 mars 1950, *Interpretimi i traktateve të paqes të lidhura në mes të Bullgarisë, Hungarisë dhe Rumanisë*, Përmbledhja 1950, f. 71.

Dokumente të tjera:

Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Rezoluta A/RES/63/3 e datës 8 tetor 2008,
<http://daccessdds.un.org/doc/UNDOC/GEN/N08/470/98/PDF/N0847098.pdf?OpenElement>

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, Urdhëresa e 21 tetorit 2008 mbi caktimin e afateve për ekspozetë e shkruara dhe vërejtjet gojore në çështjen *Pajtueshmëria me të drejtën ndërkombëtare e shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës nga institucionet e përkohshme të administrimit autonom të Kosovës*,
<http://www.icj-cij.org/docket/index.php?p1=3&p2=4&k=21&case=141&code=kos&p3=3>.

Karta e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, teksti në gjuhën frënge i disponueshëm në
<http://www.icj-cij.org/documents/index.php?p1=4&p2=1&p3=0>.

Rregullorja e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, teksti në gjuhën frënge i disponueshëm në
<http://www.icj-cij.org/documents/index.php?p1=4&p2=3&p3=0>.

Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, teksti në gjuhën frënge i disponueshëm në
<http://www.icj-cij.org/documents/index.php?p1=4&p2=2&p3=0>.